

03.11.2023

### Njoftim për Shtyp

## **U zhvillua mbledhja e radhës e Komisionit të Pavarur Ad-Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatisë**

Në institucionin e Avokatit të Popullit, në datë 03.11.2023, ora 14.00 u zhvillua mbledhja e radhës e Komisionit të Pavarur Ad-Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatisë.

Pjesëmarrës në mbledhje ishin Avokatja e Popullit, znj. Erinda Ballanca - kryetar, z. Sandër Simoni – zëvendëskryetar dhe anëtarët: z. Shaban Sinani dhe z. Sokol Puto (në cilësinë e anëtarit zëvendësues për anëtarin z. Maksim Haxhia), ndërkohë që anëtari z. Ilir Dode, për arsye objektive nuk mori pjesë në mbledhje.

I pranishëm në mbledhje, me statusin e vëzhguesit ishte gjithashtu dhe një përfaqësues nga misioni OPDAT në Shqipëri.

Në përputhje me rendin e ditës të shpërndarë paraprakisht fillimisht kryetari i komisionit informoi mbi përgjigjet e kthyer nga disa institucione (Drejtoria e Përgjithsme e Burgjeve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Prokuroritë e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Prokuroria e Posaçme Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Këshilli i Lartë Gjyqësor, etj.)

Më pas, Komisioni duke vlerësuar se me informacionet e ardhura, niveli i provueshmërisë së përmbushjes ose jo të kriterëve ligjore për disa kandidatë ishte i mjaftueshëm për vendimarrje përfundimtare, pas shqyrtimit vendosi:

1. Konstatimin e mosplotësimin të kushteve ligjore nga kandidatët: Donata Lepenica (Selmanaj), Eduard Allamani, Eduard Mullaraj, Petrit Gaçi, Sokol Dedndreaj.
2. Të njoftohen kandidatët e mësipërm në mënyrë individuale, ndërkohë që Vendimi i arsyetuar do ju dërgohet në një kohë të dytë, por në çdo rast jo më vonë se 10 ditë nga përfundimi i kësaj mbledhjeje.

Mbledhja e radhës do të caktohet në varësi të kthimit të përgjigjeve nga institucionet, të cilave ju është kërkuar informacion nga Komisioni.